



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(EMËRTIMI I INSTITUCIONIT FONDKRIJUES)  
(EMËRTESA E INSTITUCIONIT TË VARËSISË - NËSE KA)

## KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Prefekti i Qarkut, Fier, Nr. Prot. 1128/, Data 10.11.2022.  
Shkurtimi i lëndës Ethim pengjillje

Për trajtim nga: (struktura të tjera të ngarkuara)	<u>19762/</u>
Me porosi:	<u>Z. Drita Horha</u> <u>Z. Anilda Hajdini</u> <u>Me porosi</u>

Afati:  normal (7 ditë) |  Prioritet (3 ditë) |  Urgjent (brenda ditës) |  Pa afat/për dijeni

Tjetër \_\_\_ ditë

Data 11.11.2022, Nr. Prot. 19762/

Nënshkrimi: (TITULLARI) \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim (struktura): \_\_\_\_\_

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim (struktura): \_\_\_\_\_

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim Specialistit: \_\_\_\_\_

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit përfunduar më: \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit pranuar më: \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit miratuar më: \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit miratuar më: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_, Specialisti

\_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike

\_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike

\_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike

Adresa e plotë e institucionit, numri i telefonit, faqja zyrtare në internet (nëse ka), adresa e postës elektronike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT FIER  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1129 Prot.

Fier, më 10.11 2022

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 78 dhe Nr. 83 të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 31.10.2022.

**BASHKISË ROSKOVEC**  
**KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC**

**Roskovec**

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 9762 prot. datë 01.11.2022, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1129 prot. datë 04.11.2022, bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 8, shkronja “a”, neni 16, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3, pika 2, shqyrtoam ligjshmërinë e vendimeve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 31.10.2022, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 11, datë 31.10.2022, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 547, prot. datë 25.01.2022, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehemi si më poshtë:

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 78, datë 31.10.2022, “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec”** shoqëruar nga projektvendimi Nr. 78, datë 26.10.2022, protokolluar me Nr. 9615 prot. datë 26.10.2022, relacioni shpjegues Nr. 9615/1 prot. datë 26.10.2022; procesverbalet e dëgjësës publike datë 21.10.2022 mbajtur në librin Nr.2 të procesverbaleve të dëgjesave publike Nr. 437/1 Prot datë 20.10.2022 dhe Vlerësimi strategjik mjedisor **ju kthehet për arsyen e mëposhtëme:**

Vendimit i mungon dokumenti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor sipas nenit 24, të ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Vlerësimi strategjik mjedisor që i keni bashkëlidhur vendimit i përket Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec.

**Për sa më sipër Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 78, datë 31.10.2022, “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec”** është në kundërshtim me ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 13, pika 2 dhe ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” neni 24.

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 83, datë 31.10.2022, “Për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022”** shoqëruar nga projektvendimi Nr. 83, datë 26.10.2022, protokolluar me Nr. 9620 prot. datë 26.10.2022, relacioni shpjegues Nr. 9620/1 prot. datë 26.10.2022, **ju kthehet për arsyet e mëposhtëme:**

Ky vendim mbështetet nga ana juaj në ligjin Nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile” dhe VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, shkronja b.

Ligji Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 3, pika 6 përcakton se çfarë quhet emergjencë civile dhe në pikën 23 të këtij neni jep përkufizimin e mbrojtjes civile, konkretisht:

*"Emergjencë civile" është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.*

*"Mbrojtja civile" është tërësia e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.*

Në relacion ju shpjegoni se do të përdorni buxhetin e emergjencave civile për rikonstrukcionin e çatisë së shkollës "Alush Grepçka", pasi sipas jush është një situatë emergjente. Ky përfundim nuk bazohet në ligjin Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe VKM Nr. 414 datë 08.07.2021, pasi gjendja aktuale që ndodhet shkolla nuk ka ardhur si pasojë e një fatkeqësie që sjell dëme të menjëhershme, por ka ardhur si pasojë e amortizimit ndër vite. Në këto kushte nuk mund të përdoret fondi i kushtëzuar për emergjencat civile, por bashkia duhet ta kishte parashikuar si investim me fonde të tjera jashtë këtij zëri buxhetor.

Paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, pika b, e VKM Nr. 414 datë 08.07.2021, ku jeni referuar si bazë ligjore ka të bëjë me përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile "për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin e veprimtaritë e tij ekonomike".

Referimi në këtë pikë nuk është i saktë pavarësisht gjendjes në të cilën është shkolla. Moszhvillimi i mësimin në kushte optimale dhe pamundësia për të vendosur pajisjet kompjuterike në Laboratorin e Koodimit, nuk sjell çënim të objektit infrastrukturor deri në atë pikë që të bëjë kërcënim serioz për jetën e nxënësve.

**Për sa më sipër Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 83, datë 31.10.2022, "Për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022"** ju kthehet pasi është në kundërshtim me ligjin Nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile" neni 3, pika 6 dhe 23 dhe VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 pika b.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

